



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 104/02-4712/24
Kaçanik, 29.02.2024

Në bazë të nenit 12.2(d) dhe nenit 82.2 të Ligjit 03/L-040 –Për Vetëqeverisje Lokale(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/ 04 Qershor 2008), nenit 53 të Ligjit Nr. 05/L- 031-për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 19/ 16 Qershor 2016), të nenit 34.5 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, duke vepruar sipas Kërkesës së MAPL Nr. 020-111/4 të datës 13.02.2024, numri i Protokollin të komunës 01Nr. 104/02-4712/24 i datës 13.02.2024, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 29 shkurt 2024, mori këtë:

VENDIM

PËR ANULIMIN E VENDIMIT PER MIRATIM NË PARIM TË VENDIMIT 01NR. 06-104/02-1940/24 I DATËS 31.01.2024 PËR KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS, ME PRONËN E PALUAJTSHME TË PERSONIT FIZIK MEJDI (SHABI) XHOKLI

1. Me këtë vendim, ANULOHEM Vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr. 06-104/02-1940/24 i datës 31.01.2024 për miratimin në parim të Vendimit për Këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik Mejdi (Shabi) Xhokli.
2. Anulimi i Vendimit i përcaktuar si në pikën 1. të këtij Vendimi, bëhet sipas Kërkesës së MAPL Nr. 020-111/4 të datës 13.02.2024, për shkak se i njëjti nuk është në harmoni me dispozitat e legjislacionit në fuqi.
3. Pjesë përbërëse të këtij Vendimi janë: Vendimi i Anuluar 01Nr.06-104/02-1940/24 i datës 31.01.2024; Kërkesa e MAPL Nr. 020-111/4 e datës 13.02.2024 për rishqyrtim të vendimit.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit. .
6. **Me këtë Vendim njoftohen:** MAPL, Kryetari i Komunës; Drejtoria e Urbanizimit Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit (përmes kësaj drejtorie njoftohen mekanizmat tjerë relevantë), Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kacanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01Nr. 104/02-4712/24
Kačanik, 29.02.2024

Na osnovu člana 12.2 (d) i člana 82.2 Zakona 03/L-040 - O lokalnoj samoupravi (Službeni list Republike Kosovo br. 28/04. jun 2008), člana 53. Zakona br. 05/L-031- za Opšti upravni postupak (Službeni list Republike Kosovo br. 19/16. juna 2016. godine), člana 34.5 Statuta opštine Kačanik, postupajući po Zahtevu MALS-a br. 020-111/4 od 13.02.2024.godine, broj Protokola opštine 01br. 104/02-4712/24 od 13.02.2024.godine, Skupština opštine Kačanik je na sednici održanoj 29.02.2024.godine primila sledeće:

O D L U K A
ZA UKLJUČIVANJE ODLUKE ZA SAGLASNOST U NAČELU ODLUKE
01 NO. 06-104/02-1940/24 OD 31.01.2024.godine ZA ZAMENU NEPOKRETNOSTI
OPŠTINE, SA NEPOKRETNIM IMOVINOM FIZIČKOG LICA MEJDI (SHABIJ)
XHOKLI

1. Ovom Odlukom Skupština opštine 01 br. 06-104/02-1940/24 od 31.01.2024.godine za usvajanje načelne Odluke o razmeni nepokretnosti opštine sa nepokretnom imovinom fizičkog lica Mejdj (Shabi) Xhokli.
2. Ukidanje Odluke iz tačke 1. ove Odluke vrši se po zahtevu Ministarstva prosvjete i kulture br. 020-111/4 od 13.02.2024. godine, jer isti nije u skladu sa odredbama važećeg zakonodavstva.
3. Sastavni delovi ove odluke su: Poništeno rešenje 01 broj 06-104/02-1940/24 od 31.01.2024. Zahtev MAPL br. 020-111/4 od 13.02.2024.godine za ponovno razmatranje rešenja.
4. Ova Odluka stupa na snagu 15 dana od dana registracije u Službi za protokol nadzornog organa – MAPL, kao i 7 dana od dana objavljivanja na zvaničnoj internet stranici opštine.
5. O sprovođenju ove Odluke staraće se: Predsednik Opštine i Odjeljenje za urbanizam, katastar i zaštitu životne sredine.
6. Ovom Odlukom obaveštavaju se: MALS, Predsednik opštine; Uprava za urbanizaciju, katastar i zaštitu životne sredine (ostali relevantni mehanizmi se obaveštavaju preko ove direkcije), Arhiv.

Predsedavajući Skupštine
Kemal Murseli





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
01Nr. 06-104/02-1940/24
Kaçanik, 31.01.2024

Në mbështetje të nenit 12.2 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 24 dhe nenit 25 të Ligjit Nr. 06/l-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, të neni 29 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, të neni 15.3 (h) dhe (q) të Statutit të Komunës së Kaçanikut të datës 25.09.2008 dhe ndryshim plotësimit të Statutit të Komunës së Kaçanikut 01.nr.60/01-12895/2020 të datës 30.06.2020 si dhe në pajtim me Vendimin për shpallje në interes publik 01Nr.104/02-30042/2023 të datës 30.11.2023, të Propozim Vendimit të Kryetarit Komunës nëpërmjet të Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 31 janar 2024, merr këtë:

VENDIM


PER MIRATIM NË PARIM TË VENDIMIT PËR KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS ME PRONËN E PALUAJTSHME TË PERSONIT FIZIK MEJDI (SHABI) XHOKLI

1. Me këtë vendim, MIRATOHET në parim Vendimi për Këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik Mejd (Shabi)Xhokli.
2. Këmbimi i pronës së paluajtshme i cekur si në pikën 1. të këtij Vendimi, ka të bëjë me:
 - 1.1 Pjesa e parcelës Kadastrale P-70917093-00545-0, me sipërfaqe prej $S=41.72 m^2$ nga sipërfaqja e përgjithëshme prej $S=810 m^2$, në pronësi Rrugë Publike dhe të Pakategorizuar, me vendodhje "Ramadan Xhokli" Koxhaj – Kaçanik ZK Koxhaj, këmbehet me:
 - 1.2 Pjesa e parcelës Kadastrale P-70917093-00544-0, me sipërfaqe prej $S=41.72 m^2$ nga me sipërfaqe të përgjithëshme prej $S=2248 m^2$, në pronësi të personit fizik MEJDI (SHABI) XHOKLI., me vendbanim "Ramadan Xhokli"Koxhaj – Kaçanik , ZK Koxhaj.
3. Vendimi për inicimin e këmbimit të pronës së paluajtshme është që të krijohet mundësi për zgjerimin dhe rregullimin "Ramadan Xhokli" Koxhaj – Kaçanik.
4. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë: Vendim për shpallje në interes publik me nr. të protokollit 01nr.104/02-30042/2023, të datës 30.11.2023; Certifikata e pronësisë dhe kopjen e planit të pronave që janë objekt i këmbimit; Skica
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtjes së Mjedisit, gjegjësisht Zyra Komonale Kadastrale Kaçanik, e cila do të bëjë regjistrimin e pronave dhe të drejtën e pronësisë.
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës-MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës; Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit (përmes kësaj drejtorie njoftohet pala dhe mekanizma tjerë relevantë); Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data 29.02.25	Vendi KASANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë
01	105/02-4772	1

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, U. d Sekretar i Përgjithshëm në MAPL
Nga:	Besim Myrtezani, U.d Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL
Zyrtaret përgjegjës:	Datë: 09.02.2024 VI-020-111
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e Lartë për Monitorim të Komunave
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim të aktit
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim 01 Nr. 06-104/02-1940/24 për miratim në parim të Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik Mejdi (Shabi) Xhokli

I miratuar më datë: 31.01.2024

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 02.02.2024

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës, nuk është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut në mbledhjen e mbajtur me datë 31.01.2024, ka miratuar Vendimin 01 Nr. 06-104/02-1940/24 për miratim në parim të Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik Mejdi (Shabi) Xhokli.

Vendimi 01 Nr. 06-104/02-1940/24 për miratim në parim të Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik Mejdi (Shabi) Xhokli, është në kundërshtim me paragrafin 5 të nenit 25 të Ligjit 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës dhe përkatësisht me paragrafin 1.5 të nenit 31 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

Kërkesa për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës mund të iniciohet nga kryetari i komunës dhe i adresohet kuvendit të komunës apo institucionit qendror më dokumentet përkatës, duke bashkangjitur dokumentacionin sipas nenit 31 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, duke përfshirë edhe paragrafin 1.5, i cili përcakton edhe: "Vlerësimin financiar të pronave të paluajtshme të cilat janë objekt i këmbimit".

Bazuar në të lartcekurat Kuvendi i Komunës së Kaçanikut duhet të ndërmerri veprime dhe brenda afatit ligjor, prej 30 ditëve, të rishqyrtoj dhe të harmonizoj aktin më legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.